



Republika e Kosovës
Republika Kosova - RepublicofKosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipalityof Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes inauguruese të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport, mbajtur më 19.07.2022,
duke filluar në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e komitetit: Gresa Lahu -PDK, Valbona Ajeti - AAK, Endrit Zabërgja - NISMA dhe Adelina Mehiu - eksperte e jashtme.

Në mbledhje mungoj: Rita Zeqiri - VV.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Arton Braimi, përfaqësues nga Sektori për punë të Kuvendit.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport;
2. Të ndryshme.

Arton Braimi përshëndeti të pranishmit dhe tha se sot kemi mbledhjen inauguruese të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport. Këto komitete janë të formuara në bazë të Udhëzimit Administrativ 05/2020 të datës 21.12.2020 dhe Vendimit të miratuar nga Kuvendi Komunal më 10.05.2022 nr. 01-020/02-103516/22. Sot si pikë e rendit të ditës në këtë takim kemi me bërë propozimin e njërit prej anëtarëve për kryesues të komitetit dhe do ta votojmë. Endrit Zabërgja propozojë zonjën Valbona Ajeti për kryesuese të Komitetit.

Arton Braimi tha se propozime të tjera nuk ka, dhe se e mbështetin propozimin e Endrit, që Valbona Ajeti të jetë kryesuese e komitetit.

Të gjithë anëtarët e komitetit unanimisht e votuan znj. Valbona Ajeti, për kryesuese të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Valbona Ajeti tha se pranon të jetë kryesuese e këtij komitetit. Falenderon të gjithë anëtarët e komitetit dhe thotë se do të japim maksimumin rreth punëve të këtij komiteti dhe se shpreson se do të kalojmë sa më mirë.

Faqe1nga2

Arton Brahimi tha se tash e kemi kryesuesen e Komitetit dhe në bashkëpunim me të mundeni të caktioni rendin e ditës për mbledhjet e radhës dhe datën se kur ju jeni të gatshëm. Pika tjetër e rendit të ditës është të ndryshme.

Endrit Zabërgja tha se dëshiron të dijë se cilat janë të drejtat e Komitetit dhe mbi qfarë të drejte vepron ky komitet?

Arton Brahimi tha se këto komitele janë formuar duke u bazuar në Udhëziimin Administrativ 05/2020, të cilat hynë në Themelimin e komiteteve të tjera, të cilat formohen për nevojat e drejtorive, si mbështetje për kryerjen e përgjegjësive në sektor të caktuar. Prandaj ju si Komitet në bashkëpunim me Drejtoreshën e Kulturës dhe të Sportit mund të të dakordoheni për të arritur qëllime dhe objektiva sa më të mira si drejtori.

Komititetet e tjera po ashtu e dorëzojnë raportin vjetor për punën e tyre pranë Kuvendit të Komunës për shqyrëtim dhe miratim.

Valbona Ajeti tha se në legjislaturën e kaluar kam qenë pjesë e Komitetit për Arsim, ku kemi mbajtur dy mbledhje duke diskutuar ato pika të cilat ka pasur nevojë si psh: shtimi i nxënësve, klasët e tepërta, hapsirat e pakëta dhe kështu ne si komitet kemi nxjerr diqka nga ajo dhe e kemi sjellë si pikë apo rekomandim në Kuvend. Ne këtu si komitet kemi edhe një anëtare nga Jasht Kuvendit, e cila mundet të na sygjerojë diqka më ndryshe nga ajo qfarë ne shohim në Kuvend.

Endrit Zabërgja tha se ne grup premtojmë se do të jemi aktiv dhe të nxjerrim më të mirën si komitet.

Gresa Lahu tha se komitetet kur janë formuar, ne si Kuvend i Kryeqytetit a kemi marr ndonjë shembull ndonjë model si funksionojnë komitetet? Besoj se do të ishte mirë ta kemi një strategji të punës se qfarë realisht pritet nga ky komitet?

Arton Brahimi tha se ju së bashku me drejtorët e drejtorive përkatëse në këtë rast drejtoreshën e Kulturës dhe drejtorin e Sportit, në bashkëpunim me ta të krijoni një plan program të punës së Komitetit dhe në bazë të atij plani të veproni ju si komitet.

Valbona Ajeti tha se nga mbledhjet e ardhshme besoj se do të vijnë edhe drejtoresha e Kulturës edhe drejtori i Sportit dhe në bashkëpunim me ta do ta krijojmë një planë të punës.

Endrit Zabërgja tha se besojmë se do të ndryshojmë nga legjislaturat e kaluara, dhe të krijojmë një praktikë të re. Ne do të fillojmë ta formojmë një plan program të punës dhe të jemi sa më fleksibil, sepse ne këtu jemi të zgjedhur nga qytetarët dhe do të punojmë për më të mirën e tyre. Në bashkpunim me juve si kryesuese dhe me kolegët tjerë do të propozoj që të kemi së paku një mbledhje në muaj, dhe të mos varemi vetëm nga këto 6 mbledhje të cilat janë me pagesë. Në këtë komitet ju kisha lultur që të mos punojmë në vija partiake por të funksionojmë së bashku dhe të nxjerrim gjëra të mira nga ky komitet.

Valbona Ajeti tha se besoj se të dy drejtorët janë shumë komunikativ do ta kemi mbështetjen e tyre dhe do të kalojmë sa më mirë me ta.

Arton Brahimi tha se në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i komitetit.

Mbledhja përfundoi në orën 16:30

Procesmbajtësi
Arton Brahim

Faqe2nga2

Kryesuesi i mbledhjes
Valbona Ajeti

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://www.prishtina-komuna.org>

